

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 122 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 125, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike në zonat e identifikuara si zona me potencial arkeologjik* (Zëmlak KM 23, Bellovoda KM 53 dhe Leshnjë KM 58-61) gjatë vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për Projektin e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), Fushata e Dytë KM 0 – KM 69, realizuar nga shoqëri e licencuar licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike në zonat e identifikuara si zona me potencial arkeologjik* (Zëmlak KM 23, Bellovoda KM 53 dhe Leshnjë KM 58-61) gjatë vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për Projektin e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), Fushata e Dytë KM 0 – KM 69, realizuar nga shoqëri e licencuar licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Investitori "TAP AG" për kryerjen e sondazheve arkeologjike në zonat e sipërpërmendura, sipas konceptit dhe metodologjisë të paraqitur nga shoqëria e licencuar në arkeologji duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me këtë shoqëri si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.



4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO